



Drejtoria për Arsim

O F E R T Ë

Për angazhimin e trajnerëve sipas fushave të Kurrikulit të ri të Kosovës

Divizioni për Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve, ka planifikuar aktivitete që duhet të ndërmerren për mbështetjen profesionale të mësimdhënësve për zbatimin e Kurrikulit të Ri të Kosovës. Këto aktivitete kanë për qëllim të vendosin skemën e trajnimit të mësimdhënësve për të gjitha komunat e Kosovës për vitin shkollor 2018/2019, të cilat do të punojnë me kurrikulën e re. Ky plan i veprimit, përcakton objektivat kryesore për mbështetjen profesionale të mësimdhënësve për zbatimin e Kurrikulit të Ri të Kosovës, realizimi i të cilave do të ofrojë cilësi më të mirë të përkrahjes së nxënësve drejt zotërimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore.

Në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e DZHPM për të trajnuar dhe aftësuar trajnerët dhe ekspertët në nivel të komunave të Kosovës për krijimin e grupeve profesionale që ndihmojnë zbatimin e reformës arsimore, DKA ne bashkëpunim me MASHT shpallë ofertë për përzgjedhjen e trajnerëve dhe ekspertëve sipas fushave të Kurrikulit të ri të Kosovës, të cilët duhet të plotësojnë këto kriterë:

1. Të jetë mësimdhënës i rregullt në shkollat publike të Republikës së Kosovës, përparësi ka mësimdhënësi e licencuar.
2. Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në mësimdhënie/arsim;
3. Të jetë në lëmin/fushën përkatëse për të cilat është i thirrur për mbajtjen e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i.
4. Të jenë të certifikuar si trajnerë ose si pjesëmarrës sipas programeve të akredituara nga MASHT-i, e sidomos nga programet bazike/themelore.
5. Të ketë dëshmi/raport vlerësues nga drejtori i shkollës për rezultatet e punës me nxënës si mësimdhënës i certifikuar në programet e përmendura më lartë;
6. Të njohë mirë Kurrikulën e re të Kosovës, me përparësi për ata të cilët kanë qenë në pilotim dhe zbatim të KK-së së Re.
7. Të njoh mirë përdorimin e kompjuterit;
8. Të jetë person kreativ, bashkëpunues, për secilin aktivitet trajnues dhe mentorues dhe të raportojë me kohë;
9. Të respektojë marrëveshjen me përpikëri;

<i>Gjuhë dhe Komunikim</i>	<i>Arte</i>	<i>Matematikë</i>	<i>Shk. natyrore</i>	<i>Shoqëria dhe Mjedis</i>	<i>Edukimi fizik</i>	<i>TIK</i>	<i>Parafillor dhe Fillor</i>	<i>Kurrikula me zgjedhje</i>
2	2	2	2	2	2	2	2	2

Detyrat kryesore

Trajnerët e angazhuar nga DKA, kanë këto detyra dhe obligime:

- Të analizojnë dokumentet e KK-së dhe KB-ve sipas niveleve.
- Analizojnë Udhëzuesin për zbatimin e kurrikulës në fushën përkatëse.
- Të prezantojnë informacionet dhe njohuritë sipas dokumenteve të Kurikut të ri të Kosovës dhe përmbajtjeve materiale dhe shkencore.
- Përgatisin planin e trajnimit 5 ditor – sipas seancave dhe materialet për prezantim në seancat e trajnimeve.
- Të bëjnë organizimin dhe mbajtjen e trajnimit sipas agjendës dhe ditëve të trajnimit
- Mbajnë në evidencë listën e pjesëmarrësve të përfshirë në trajnimin për trajnerë
- Të sigurojnë lloptop dhe projektor për prezantimin e punës së tyre në seancat e trajnimit
- Të përmbledhin – integrojnë dhe përpunojnë modelet praktike të planifikimit për shkallë të kurrikulës, planeve vjetore dhe dymujore të përgatitura gjatë trajnimit dhe nga detyrat e dhe u shpërndajnë trajnerëve të rinj dhe mësimdhënësit, si modele pune gjatë trajnimit të mësimdhënësve
- Të përgatisin raportin e punës sipas ditëve të angazhimit për trajnimin e trajnerëve/mësimdhënësve.
- Të përgatisin një raport të vlerësimit për trajnerët e rinj/mësimdhënësit.
- Të përgatisin së bashku me trajnerët e rinj planin e trajnimit 5 ditor për të gjitha seancat e trajnimit të mësimdhënësve në rajone dhe e dorëzojnë në divizionin për Zhvillim profesional të mësimdhënësve në MASHT- më se voni .
- Të mbajnë evidencën në mënyrë korrekte për pjesëmarrësit në trajnim dhe të bëjnë vlerësimin e secilit pjesëmarrës.
- Të raportoj kordintaorit komunal për agjenden e ditëve të trajnimit dhe ecurin e secilës ditë të trajnimit

Si më sipër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, bazuar në legjislacionin në fuqi, do të marrë vendim për angazhimin e trajnerëve të poshtëshënuar sipas fushave të Kurikut të ri:

Të interesuarit do të paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën
- Kopjen e diplomës nga kualifikimi
- CV personale dhe
- Një referencë nga drejtori i shkollës bazuar në vlerësimin e tij/saj.

Të gjitha dokumentet duhet të përcillen me dëshmi

Oferta do të jetë e hapur nga data 25 maj dhe mbetet i hapur 15 nga dita e publikimit. Aplikacionet merren dhe dorëzohen bashkë me dokumentet në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Klinë.

Drejtori i DKA-së
Arben Limani





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

FORMULAR APLIKIMI PËR MËSIMDHËNËS TRAJNER

Qëllimi: Trajnimi i mësimeve - Implementimi i Kurikulës së re

UDHËZIMET: Ju lutem përgjiguni në çdo pyetje qartë dhe komplet

Mbiemri:	Emri shkollës ku punon:		Emri i institucionit ku jeni kualifikuar:		
Emri:	Lënda/Fusha që punoni aktualisht:		Diploma thirrja akademike:		
Data, Muaji, Viti i Lindjes:	Përvoja e punës:	Nr. i trajnimeve të Akredituara:	Vitet e vijimit (përiudha e studimeve):		
Vendbanimi:	Sa vite pune keni që jeni përfshir në proces të KK dhe në çfarë forme:				
		Tjetër	Pozita	Kordinator / mësimeve (shëno).	
				Shkolle	Fushe
Njohuri për përdorimin e kompjuterit	Mirë Pak Jo	Shëno trajnimet që ju kanë ndihmuar më së shumti në implementimin e Kurikulës së re.		Shëno fushën e kurikulare në të cilën do të zhvillonit aktivitetin tuaj trajnues	
Power Point					
Word				Vlerëso dosjen personale të procesit mësimor (në hapsirën e zbrazët shëno vlerësimin e fundit nga trajneri)	
Excel					
Internet				E kompletuar	Relativisht e kompletuar

Të interesuarit do të paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën/Formularin
- Kopjen e letërnjoftimit
- Kopjen e diplomës nga kualifikimi
- Kopjen e çertifikatave të trajnimeve
- CV personale
- Vërtetim i përvojës së punës
- Një referencë nga drejtori i shkollës bazuar në vlerësimin e tij/saj.
- Për çdo detaj të shënuar në aplikacion në fazën e konkursit ofroni dëshmi.

Email adresa	
Nr. Telefonit	

Data e aplikimit	Nënshkrimi i Aplikuesit

